# DËSHMI ARKIVI

**A-448665**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Verdikti i Hagës - Dënohen ish krerët e UÇK-së/ Vajza e Jakup Krasniqit: Sot, në qytetin e drejtësisë, ndodhi padrejtësia më e madhe e këtij shekulli |
| ADRESA | `https://www.syri.net/kosova/917036/denohen-ish-kreret-e-uck-se-vajza-e-jakup-krasniqit-sot-ne-qytetin-e-drejtesise-ndodhi-padrejtesia-me-e-madhe-e-ketij-shekulli/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 10:28:43 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 10:20:20 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6ad3889a7a94aa7586b9ff64a315b9e3bfc41b81e99e1c6c997f235e37f91e86` |
| TEKSTI | `d84539088de41218a8820130d2d245eb30d70fc6309846fda062db484ffac893` |
| PAMJA | `f4b35ac011dc68b5367809998330073a7baa5f579d9ef5ebb56c91db67aec430` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `eafaa9f5f0fa8b1c120b8551daede59e5670af2c9685051cf9e114ebf0b7ac82` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `1f56947d1ce9865195ccff7ffa5c5fdb522467bff0934ba4720654b865868030` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/eafaa9f5f0fa8b1c120b8551daede59e5670af2c9685051cf9e114ebf0b7ac82`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

syri



**ILIR KALEMAJ**

Dokrra hini dhe bota në tranzicion



**ENVER BYTYÇI**

Edi Rama edhe në varr nuk ndahet nga Aleksandër Vuçiq!



# Dënohen ish krerët e UÇK-së/ Vajza e Jakup Krasniqit: Sot, në qytetin e drejtësisë, ndodhi padrejtësia më e madhe e këtij shekulli

12:20, 16/09/2026

Trupi Gjykues i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ka shpallur aktgjykimin ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi. Thaçi dhe Krasniqi janë dënuar me nga 25 vjet burgim, Veseli me 18 vjet, ndërsa Selimi me 13 vjet burgim. Të katër të akuzuarit janë shpallur fajtorë për katër pika të krimeve të luftës, ndërsa trupi gjykues i ka shpallur të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit.

Menjëherë pas vendimit ka reaguar në një postim në facebook vajza e Jakup Krasniqit,  Gresa Krasniqi

*Së dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,*
*Sot, në qytetin e drejtësisë, ndodhi padrejtësia më e madhe e këtij shekulli.*

*Në një gjykatë që ne e konsiderojmë të padrejtë, politike, raciste dhe kriminale, u dha një vendim po aq i padrejtë, politik, racist dhe kriminal. Ky vendim, perfundimisht, ndryshon historinë e Republikës së Kosovës, i vendosë një njollë të zezë UÇK-së dhe barazon viktimën me agresorin.*
*Katër burra që i kthyen armët kundër armikut, jo për të pushtuar e as për pushtet, por për të mbrojtur pragun e shtëpisë që digjej e shkatërrohej; për të mbrojtur familjarët që dhunoheshin, përdhunoheshin, torturoheshin e vriteshin; që zhdukeshin e dëboheshin nga trojet e tyre.*
*UÇK-ja luftoi kundër kasapit të Ballkanit, kundër një prej ushtrive më të përgjakshme të rajonit, kundër një makinerie ushtarake që kreu gjenocid në Kosovë. E megjithatë, sot u dënuan çlirimtarët.*
*Në këtë gjykatë te padrejt, sot u dënua zëdhënësi i UÇK-së, ndërsa homologu i tij i atëhershëm, Ivica Daçiq, vazhdon të jetë i lirë dhe të jetojë krejt mirë në Beograd. Ky eshte vec nje tjeter tregues i qarte per natyren paragjykuese dhe politike te po kesaj gjykate.*
*Natyrisht, ky vendim na ka lënduar dhe na ka zhgënjyer, Por kurrë nuk do të na thyejë dhe kurrë nuk do të na dorëzojë.*
*Unë jetoj dhe do të vdes me bindjen time të plotë në pafajësinë dhe çiltërsinë e babait tim, Hashimit, Kadriut dhe Rexhës.*
*Krenaria mbetet. E vërteta mbetet.*
*Ne do ta vazhdojmë luften për liri dhe drejtesi*

## më të lexuarat

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

PDK dërgon në Kushtetuese konstituimin e Kuvendit

Gjykata Speciale: Katër të akuzuarit janë penalisht përgjegjës për krime lufte!

Kurti thirrje liderëve politikë: Ta zgjidhim çështjen e presidentit

Ndërron jetë Flora Brovina, nesër do të dëshmonte për Masakrën e Dubravës

Hashim Thaçi dënohet me 25 vjet burgim për krime lufte

Edhe Jakup Krasniqi dënohet me 25 vjet burgim

© SYRI.net

Lexo edhe:



DOKUMENTI/ Publikohet vendimi i plotë i dënimit të Thaçit dhe të tjerëve



Dënimi i ish krerëve të UÇK/ Komandanti Haradinaj: Shkelje e të drejtave të njeriut, mbrojtën lirinë e Kosovës



Gjini: Ky aktgjykim s'mund ta ndryshojë të vërtetën historike të Kosovës

# Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

TË NGJASHME

Reagon familja e Hashim Thaçit: Po presim Apelin, jemi të bindur në pafajësi

Marre! Gratë me lot në sy: Duhej të ishin dënuar ata që përdhunuan 20 mijë femra, jo shpëtimtarët tanë

Konjufca: Vendim i padrejtë dhe i pamerituar

Gjykata Speciale dënoi 4 ish krerët e UÇK-së, qytetarët në Prishtinë të indinjuar: Vendimi jo në emër të popullit

Mbyllet seanca në Hagë: Thaçi e Krasniqi dënohen me nga 25 vite burg, Veseli 18 vite e Selimi 13 vite

Rexhep Selimi dënohet me 13 vjet burgim



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.